

**“Per ndarjen e ceshtjeve”
ne Gjykatën e Apelit Tirane**

I. Ndarja e ceshtjeve ne Gjykatën e Apelit Tirane behet ne respektim te :

1. Nenit 42 te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, sipas te cilit *“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*;
2. Nenit 71 te Kodit te Procedures Civile, sipas te cilit *“Kushtet per te gene gjyqtar caktohen me ligj”*;
3. Nenit 154/a te Kodit te Procedures Civile, sipas te cilit *“Padia iu caktohet gjyqtareve me short”*;
4. Nenit 9 te Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, sipas te cilit *“Ndarja e ceshtjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”*;
5. Vendimit Nr.238/1/a, date 24.12.2008, te Keshillit te Larte te Drejtësisë *“Per procedurat e ndarjes me short te ceshtjeve gjyqësore”*, sipas te cilit **duhet plotësuar ... “ndarja e ceshtjeve behet me short elektronik**”.


II. Shorti elektronik per ndarjen e ceshtjeve konsideron nder te tjera :

1. Regjistrimin elektronik te te gjitha ceshtjeve, qofte te atyre te ardhura mbi ankimin e paleve kunder vendimit te gjykatave te shkalles se pare, ashtu dhe te atyre per te cilat gjykata e apelit eshte ngarkuar nga ligji per shqyrtimin fillestar te tyre.

2. Ndarjen me short te te gjitha ceshtjeve, me përjashtim te ceshtjeve qe lidhen me masat e sigurimit ne fushen penale, per ndarjen e te cilave respektohet rregulli sipas te cilit ato iu ngarkohen gjyqtareve te caktuar paraprakisht ne fillim te cdo viti ne baze listes se përgatitur sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin.
3. Hedhjen e shortit ne menyre periodike, cdo 7 dite, per te gjitha ceshtjet per te cilat ka përfunduar procesi i regjistrimit elektronik.
4. Përzgjedhjen per shortim te te gjitha ceshtjeve te regjistruara brenda harkut kohor te 7 diteve, duke mos patur askush te drejte, perfshire dhe Kryetarin e Gjykates, per te zgjedhur se cilat prej ceshtjeve do te shortohen.
5. Shortimin e ceshtjeve sipas fushave perkatese (civile dhe penale), duke siguruar nje shperndarje te barabarte te ceshtjeve te regjistruara midis gjyqtareve sipas dhomave respektive (civile dhe penale), pa marre parasysh ngarkesen momentale te gjyqtareve (numrin e ceshtjeve ne dore apo numrin e atyre te përfunduara).
6. Garantimin e te njëjtit probabilitet/mundesie perzgjedhje per te gjithë gjyqtaret aktiv (ku nuk përfshihen gjyqtaret e përjashtuar nga gjykimi i ceshtjes, per te cilet eshte miratuar doreheqja, qe jane pezulluar me vendim te Keshillit te Larte te Drejtesise apo iu eshte dhene leje afatgjate prej tij), ku ne varesi te numrit te ceshtjeve te shortuara dhe te gjyqtareve aktive ne momentin e shortit, shorti siguron qe secili nga gjyqtaret do te marr te pakten 1 ceshtje ne rastin kur numri i ceshtjeve eshte me i madh se numri i gjyqtareve.
7. Përzgjedhjen e rastësishme te gjyqtarit relator te ceshtjes, duke u përzgjedhur ne kete menyre automatikisht edhe dy anetaret e tjere te trupit gjykues referuar shperndarjes 2-vjecare te gjyqtareve ne dhomat respektive (civile dhe penale), si dhe trupa gjykues per secilen dhome.
8. Te gjitha ceshtjet gjyqesore (civile, penale) ne te cilat perjashtohet relatori ose ka dhene doreheqjen, (doreheqje e miratuar nga titullari gjykates) rihidhen ne short elektronik si me poshte:

- Ceshtjet ne te cilat perjashtohet relatori do te hidhen ne short ndermjet dy anetareve te tjere te trupit gjykues.
- Ceshtjet ne te cilat perjashtohet relatori dhe nje anetari trupit gjykues i kalon per shqyrtim si relator anetarit te trete te trupit gjykues.
- Ceshtjet ne te cilat perjashtohen te tre anetaret do te rihidhen ne short ndermjet gjyqetareve te tjere.

9. Rindarjen me short te nje grupi ceshtjesh, referuar hershmerise se regjistrimit te tyre, vetem ne raste perjashtimore dhe vetem përpara se ato te jene vene ne lëvizje (te jete shpallur data e gjykimit), me vendim te motivuar te Kryetarit te Gjykates ne funksion te qëllimit per te siguruar nje shpërndarje te barabarte e ceshtjeve midis gjyqtareve ne rastin e shtimit te numrit te gjyqtareve ne gjykate dhe per te shmangur diferencat kohore te gjykimit te këtij grupi ceshtjesh ne raport me ceshtjet e tjera.

KRYETARI

ALAUDIN MALAJ

II. Shorti elektronik per ceshtjet e ceshtjeve konsideron ndarje tjera :

1. Regjistrimin elektronik te te gjitha ceshtjeve, ne nje te nje dite te ardhura nise ankimin e paleve kunder vendimit te gjykatave te shkalles se pare, ashtu dhe te nje dite te nje dite per te cilat gjykata e apelit ashtu ngarkuar nga ligji per shqyrtimin fillestar te tyre.